

Ligj për librat shkollorë për arsim fillor dhe të mesëm

Ligj për librat shkollorë për arsim fillor dhe të mesëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 98/2008; 99/2009; 83/201; 36/2011; 135/2011; 46/2012; 24/2013; 120/2013 dhe 29/2014).

I. Dispozitat themelore

Neni 1

(1) Me këtë ligj rregullohet botimi i librave shkollorë për arsimin fillor dhe të mesëm.

(2) Me botim librash nënkuptohet përgatitja, përpunimi dhe lejimi i librave shkollorë si mjet mësimor bazë.

Neni 2

Libër shkollor në kuptim të këtij ligji është mjeti mësimor bazë dhe burim i dijes për realizimin e qëllimeve edukativo-arsimore të përcaktuara me plan-programet mësimore të arsimit fillor dhe të mesëm.

Neni 3

(1) Librat shkollorë botohen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

(2) Për nxënësit nga pjesëtarët e bashkësive që mësimin e ndjekin në gjuhë dhe alfabet të ndryshëm nga gjuha maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, librat shkollorë botohen në gjuhën dhe alfabetin në të cilin zhvillohet mësimi.

Neni 4

(1) Libri shkollor hartohet sipas plan-programit mësimor për klasën dhe lëndën përkatëse dhe Konceptin për libër shkollor, që me propozim të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit (në tekstin e mëtejme: Byroja) e përcakton ministri kompetent për arsim (në tekstin e mëtejme: ministri).

(2) Me Konceptin për libër shkollor përcaktohen bazat shkencore-profesionale dhe metodologjike të librit shkollor, funksionet zhvilluese edukativo-arsimore, bazat për motivim dhe mësim të pavarur, standardet didaktike-metodike për zgjedhjen dhe sistematizimin e përmbajtjeve, tekstet plotësuese, shtojcat vizuale, si dhe niveli përkatës i gjuhës sipas moshës së nxënësve dhe formimi i kulturës gjuhësore.

Neni 5

(1) Për një lëndë mësimore për përdorim lejohet vetëm një libër shkollor.

(2) Për lëndët mësimore për të cilat përdoren libra shkollorë të adaptuar nga vende të huaja, mund të lejohet një libër shkollor me material shoqëruës pune dhe didaktik të cilin Ministria e Arsimit dhe Shkencës (në tekstin e mëtejshëm: Ministria) e blen për përdorim, në pajtim me ligjin.

Neni 5-a

Në arsimin fillor dhe të mesëm për lëndët mësimore mund të përdoren libra shkollorë përkatës të adaptuar nga të harmonizuar me programin e miratuar mësimor të adaptuar dhe të përkthyer nga Qendra Ndërkombëtare për Programe Mësimore të Kembrixhit (Cambridge International Examinations) (në tekstin e mëtejshëm: Libra të adaptuar nga jashtë), të përkthyer në gjuhët në të cilat realizohet mësimi në Republikën e Maqedonisë.

Neni 6

Librat shkollorë në shkollat publike fillore dhe të mesme janë falas.

Neni 6-a

(1) Në shkollën fillore mund të përdoret literaturë profesionale dhe revista për fëmijë, ndërsa në shkollën e mesme literaturë profesionale.

(2) Ministria me propozimin e komisionit të formuar nga ministri, jep pëlqimin për përdorimin e literaturës profesionale, përkatësisht të revistave për fëmijë në shkollën fillore dhe të mesme, me mendimin paraprak të Byrosë, përkatësisht të Qendrës për Arsim dhe Trajnim Profesional.

(3) Në shkollën fillore ndalohet shitja e literaturës profesionale dhe revistave për fëmijë, përkatësisht literaturës profesionale në shkollë të mesme.

II. Komisioni nacional për libra shkollorë

Neni 7

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Qeveria) formon Komision nacional për libra shkollorë (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni nacional).

(2) Komisioni nacional përbëhet prej 21 anëtarëve, të cilët i emëron dhe i shkarkon Qeveria edhe atë: katër anëtarë nga institucionet shkencore dhe të arsimit të lartë nga sfera e gjuhëve, dy anëtarë nga institucionet shkencore dhe të arsimit të lartë nga sfera e shkencave shoqërore-humane, katër anëtarë nga institucionet shkencore dhe të arsimit të lartë nga sfera e shkencave natyrore, matematika dhe teknika, katër anëtarë nga institucionet shkencore dhe të arsimit të lartë nga sfera e arteve dhe të sportit dhe shtatë anëtarë nga shkollat fillore dhe të mesme.

(3) Qeveria emëron kryetar të Komisionit nacional nga radhët e anëtarëve të përcaktuar në paragrafin (2) të këtij neni.

(4) Gjatë emërimit të anëtarëve të Komisionit nacional zbatohet parimi i përfaqësimit adekuat dhe i drejtë i bashkësive në Republikën e Maqedonisë, duke pasur parasysh gjuhët në të cilat zhvillohet mësimi në arsimin fillor dhe të mesëm, pa u cenuar kriteret e përcaktuara me këtë ligj.

(5) Kryetari dhe anëtarët e Komisionit nacional emërohen me mandat dyvjeçar me mundësi riemërimi.

(6) Kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Nacional u takon kompensim për punë në Komisionin Nacional, lartësinë e të cilit e përcakton Qeveria, në bazë të pjesëmarrjes në mbledhjet e komisionit.

Neni 8

(1) Komisioni nacional e rregullon punën e vet me rregullore.

(2) Për punën e vet Komisioni nacional përgatit raport vjetor dhe ia dorëzon Qeverisë më së voni deri më 31 janar.

(3) Punët profesionale-administrative për Komisionin nacional i bën Shërbimi pedagogjik.

Neni 9

(1) Kompetencat e Komisionit Nacional janë:

- nga recensentët nga sfera adekuate shkencore të formojë komisione të recensentëve për dorëshkrimet e librave shkollorë,
- dorëzon mendim nga komisionet e recensentëve për libra shkollorë të adaptuar nga jashtë te drejtori i Shërbimit pedagogjik,
- në shpalljen publike nga neni 16 paragrafi (1) të këtij ligji nëse nuk paraqitet kandidati i sferës shkencore adekuate, zgjedh recensentë në komisionin e recensentëve për dorëshkrimet e librave shkollorë nga radhët e arsimtarëve në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë të cilët i plotësojnë kushtet për recensentë të dorëshkrimit të librave shkollorë,
- nga radhët e anëtarëve të tij përcakton anëtar referues cili do t'i referojë kryetarit dhe anëtarëve të tjerë të Komisionit Nacional për vlerësimet profesionale të dorëshkrimeve të librave shkollorë sipas lëndëve adekuate nga komisionet e recensentëve dhe për mendimin nga Byroja për harmonizimin e dorëshkrimit të librave shkollorë me programin mësimor,
- të mbajë debat për vlerësimet profesionale të dorëshkrimeve për libra shkollorë për lëndë adekuate nga komisionet e recensentëve dhe mendimi nga Byroja dhe të vendosë nëse vlerësimin profesional respektivisht mendimin do ta pranojë ose nuk do ta pranojë,
- nëse vlerëson se ka lëshime të rëndësishme dhe jokonsekuencë në vlerësimin profesional të dorëshkrimeve të librave shkollorë në lëndë përkatëse nga komisionet e recensentëve, mund të mos e pranojë atë, ta shpërbëjë komisionin e recensentëve dhe të formojë komision profesional të përbërë së paku prej tre anëtarëve nga radhët e arsimtarëve në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë të cilët i plotësojnë kushtet për recensente të dorëshkrimeve të librave shkollorë dhe që do të kryejë revizion të vlerësimit profesional të dorëshkrimeve të librave shkollorë,
- të miratojë vendim për lejim dhe përdorim të tekstit shkollor në arsimin fillor, respektivisht arsim të mesëm ose vendim se nuk kryen zgjedhje nga dorëshkrimet e dorëzuara për libra

shkollorë dhe

- kryen edhe punë tjera të përcaktuara me ligj.

(2) Mandati i anëtarit të Komisionit Nacional mund të ndërpritet edhe para kalimit të mandatit të përcaktuar në nenin 7 paragrafi (5) të këtij Ligji, në rast se libri mësimor tërhiqet nga përdorimi për shkak të gabimeve profesionale në dorëshkrimin e librit mësimor.

(3) Komisioni Nacional për mbledhjet e mbajtura detyrimisht mban procesverbal.

III. Procedura për botimin e librave shkollorë

Neni 10

(1) Autori i librit është person me arsim sipëror, magjistër ose doktor i shkencave, arsimi i të cilit është nga sfera e lëndës mësimore për të cilën dedikohet libri dhe i cili ka së paku dhjetë vjet përvojë pune si arsimtar në arsimin fillor, të mesëm ose të lartë për lëndë adekuate mësimore për të cilën është dedikuar libri shkollor.

(2) Autori i librit mund të jetë edhe personi me arsim sipëror, magjistër ose doktor i shkencave, arsimi i të cilit është adekuat sipas programit mësimor për lëndën mësimore për të cilën dedikohet libri dhe i cili ka së paku dhjetë vjet përvojë pune si arsimtar në arsimin fillor, të mesëm ose të lartë në mënyrë përkatëse sipas programit mësimor për lëndën të cilës i dedikohet libri shkollor.

Neni 11

(1) Punonjësi i Ministrisë, i organeve në përbërje të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (në tekstin e mëtejshëm: Ministria), i Qendrës së arsimit dhe të aftësisë profesionale dhe i Qendrës për arsimin e të rriturve nuk mund të jetë autor i librit.

(2) Kryetari dhe anëtari i Komisionit nacional, si dhe anëtari i komisionit recensues nuk mund të jenë autorë të librit.

Neni 12

(1) Programin për botimin e librave shkollorë e përpilon Byroja në bashkëpunim me Qendrën e arsimit dhe trajnimit profesional dhe me Qendrën e arsimit të të rriturve, ndërsa e miraton ministri.

(2) Shërbimi pedagogjik, në bazë të programit nga paragrafi (1) i këtij neni, shpall konkurs për botimin e librave veç e veç për secilën klasë dhe lëndë.

(3) Konkursi nga paragrafi (2) i këtij neni zgjat së paku një, e më së shumti deri në gjashtë muaj.

(4) Në konkurs përcaktohen kushtet që duhet t'i plotësojë autori dhe standardet që duhet t'i plotësojë libri, në pajtim me Konceptin për libra të arsimit fillor dhe të mesëm.

(5) Në konkurs mund të merr pjesë autori i librit vetëm me një dorëshkrim për libër shkollor për një lëndë mësimore.

Neni 13

(1) Për përdorimin e librave të gjuhëve të huaja leje mund të kërkojë botuesi i vendit, si dhe botuesi i shtetit të huaj në të cilin është regjistruar për veprimtari botuese, nëpërmjet përfaqësuesve ligjorë të autorizuar në Republikën e Maqedonisë.

(2) Lejen nga paragrafi (1) i këtij neni e jep Shërbimi pedagogjik.

(3) Leja nga paragrafi (1) i këtij neni mund të kërkohet në periudhë prej muajit nëntor deri në muajin mars.

(4) Ministria mund të blejë numër të nevojshëm të librave shkollorë të lejuar për gjuhë të huaja, për sigurimin e librave shkollorë falas për nxënësit në arsimin fillor dhe të mesëm.

(5) Mënyrën e dhënies së lejes nga paragrafi (1) i këtij neni e përcakton ministri.

Neni 13-a

(1) Nëse Shërbimi pedagogjik nuk lejon libër shkollor të harmonizuar me program mësimor të adaptuar dhe të përkthyer nga Qendra Ndërkombëtare për Programe Mësimore të Kembrixhit (Cambridge International Examinations) në pajtim me nenin 13-b të këtij ligji, dorëzon kërkesë te Shtëpia Botuese e Universitetit të Kembrixhit (Cambridge University Press) për përpilim të librit shkollor të adaptuar nga jashtë në pajtim me dispozitat e këtij neni.

(2) Shtëpia Botuese e Universitetit të Kembrixhit (Cambridge University Press) librin shkollor të adaptuar nga vendi i huaj e dorëzon në afat prej 180 ditësh.

(3) Shërbimi Pedagogjik, librin shkollor të adaptuar nga vendi i huaj e dorëzon te Komisioni i Recensentëve dhe te Byroja, përkatësisht Qendra për Arsim dhe Trajnim të Mesëm Profesional, në afat prej shtatë ditësh nga dita e marrjes nga Shtëpia Botuese e Universitetit të Kembrixhit (Cambridge University Press).

(4) Komisioni i Recensentëve kryen vlerësim profesional të librit shkollor të adaptuar nga vendi i huaj, në afat prej 14 ditësh nga dita e pranimit të librit shkollor të adaptuar nga vendi i huaj dhe e dorëzon vlerësimin profesional të librit shkollor të adaptuar nga vendi i huaj te drejtori i Shërbimit Pedagogjik.

(5) Byroja, përkatësisht Qendra për Arsim dhe Trajnim të Mesëm Profesional, në afat prej shtatë ditësh nga dita e pranimit të librit shkollor të adaptuar nga vendi i huaj, te drejtori i Shërbimit Pedagogjik dorëzon mendim të arsyetuar për harmonizimin e librit shkollor të adaptuar nga vendi i huaj me programin mësimor.

(6) Drejtori i Shërbimit Pedagogjik në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të vlerësimit profesional nga Komisioni i Recensentëve dhe mendimit pozitiv nga Byroja, përkatësisht Qendra për Arsim dhe Trajnim të Mesëm Profesional, miraton leje për përdorimin e librit shkollor të adaptuar nga vendi i huaj.

(7) Librin shkollor të adaptuar të lejuar nga vendi i huaj Ministria e blen në pajtim me ligjin.

(8) Ministri dhe Shtëpia Botuese e Universitetit të Kembrixhit (Cambridge University Press) nënshkruajnë marrëveshje për blerjen e librit shkollor të adaptuar nga vendi i huaj në të cilin përcaktohen të drejtat dhe obligimet e ndërsjella.

(9) Mënyrën e kryerjes së recensimit të librit shkollor të adaptuar nga vendi i huaj e rregullon ministri me propozim të Byrosë.

Neni 13-b

(1) Kërkesa për lejimin e librit shkollor të adaptuar nga jashtë dorëzohet pas ftesës publike të shpallur paraprakisht për interes për dorëzim të librave shkollorë të adaptuar nga jashtë të harmonizuar me programin e miratuar mësimor të adaptuar dhe të përkthyer nga Qendra Ndërkombëtare për Programe Mësimore të Kembrixhit (Cambridge International Examinations).

(2) Ftesën publike nga paragrafi (1) të këtij neni e shpall Shërbimi Pedagogjik pas programit të miratuar mësimor të dorëzuar të adaptuar dhe të përkthyer nga Qendra Ndërkombëtare për Programe Mësimore të Kembrixhit (Cambridge International Examinations) nga Byroja, përkatësisht Qendra për arsim profesional dhe trajnim.

(3) Ftesa publike nga paragrafi (1) të këtij neni zgjat më së paku një, ndërsa më së shumti dy muaj nga dita e shpalljes së ftesës publike.

(4) Në ftesën publike nga paragrafi (1) të këtij neni mund të paraqitet botuesi i vendit, si dhe botuesi i jashtëm i cili është i regjistruar për veprimtari botuese në shtetin në të cilin e ka selinë (në tekstin e mëtejme: botues nga jashtë), nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar ligjorë në Republikën e Maqedonisë.

(5) Me kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni, botuesi i vendit, si dhe botuesi i jashtëm, nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar ligjorë në Republikën e Maqedonisë detyrimisht dorëzon:

- libër shkollor të adaptuar nga jashtë, të përkthyer në gjuhën maqedonase, të përpunuar në mënyrë artistike dhe grafike dhe i rregulluar gjuhësisht në gjashtë ekzemplarë prej të cilëve pesë në formë të shtypur dhe një në formë elektronike,
- deklaratë nga lektori për rregullim gjuhësor të tekstit,
- listë të personit/personave, të cilët e kanë përkthyer librin shkollor të adaptuar nga jashtë dhe
- dokumente tjera të theksuara në ftesën publike.

(6) Shërbimi Pedagogjik librin shkollor të adaptuar nga jashtë e dorëzon te komisioni i recensentëve dhe te Byroja, përkatësisht Qendra për Arsim të Mesëm Profesional dhe Trajnim, në afat prej shtatë ditëve nga dita e përfundimit të ftesës.

(7) Drejtori i Shërbimit Pedagogjik nga recensentët nga neni 16 paragrafi (1) i këtij ligji, e formon komisionin e recensentëve, që kryen vlerësim profesional të librave shkollorë të adaptuar nga jashtë, në pajtim me Metodologjinë për vlerësim të librave shkollorë.

(8) Komisioni i recensentëve kryen vlerësim profesional të librit shkollor të adaptuar nga jashtë, në afat prej 14 ditëve nga dita e pranimit të librit shkollor të adaptuar nga jashtë dhe e dorëzon vlerësimin profesional të librit shkollor të adaptuar nga jashtë te drejtori i Shërbimit Pedagogjik.

(9) Byroja, përkatësisht Qendra për Arsim të Mesëm Profesional dhe Trajnim, në afat prej shtatë ditësh nga dita e pranimit të librit shkollor të adaptuar nga jashtë te drejtori i Shërbimit Pedagogjik dorëzon mendim të arsyetuar për harmonizimin e librit të adaptuar nga jashtë me program mësimor të miratuar të adaptuar dhe të përkthyer nga Qendra Ndërkombëtare për Programe Mësimore të Kembrixhit (Cambridge International Examinations).

(10) Nëse në ftesën e shpallur publike nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk dorëzohet asnjë kërkesë për lejim të librit të adaptuar nga jashtë, përkatësisht nuk miratohet leje për përdorim të librit shkollor të harmonizuar me program të miratuar mësimor të adaptuar dhe të përkthyer nga Qendra Ndërkombëtare për Programe Mësimore të Kembrixhit (Cambridge International Examinations), veprohet në pajtim me dispozitat e nenit 13-a të këtij ligji.

(11) Lejen për përdorim të librit shkollor të harmonizuar me programin e miratuar mësimor të adaptuar dhe të përkthyer nga Qendra Ndërkombëtare për Programe Mësimore të Kembrixhit (Cambridge International Examinations), nga neni 5-a i këtij ligji, e jep Shërbimi Pedagogjik në afat prej tri ditëve nga dita e pranimit të vlerësimit profesional nga komisioni i recensentëve dhe mendimit pozitiv nga Byroja, përkatësisht Qendra për Arsim të Mesëm Profesional dhe Trajnim.

(12) Kundër lejes nga paragrafi (11) i këtij neni, në afat prej tetë ditëve nga dita e pranimit të lejes, mund të parashtrohet ankesë te Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(13) Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë vendos për ankesë të parashtruar në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të ankesës.

(14) Ministria e blen librin shkollor të adaptuar nga jashtë të harmonizuar me programin e miratuar mësimor të adaptuar dhe të përkthyer nga Qendra Ndërkombëtare për Programe Mësimore të Kembrixhit (Cambridge International Examinations) në pajtim me ligj për sigurim të librave shkollorë për nxënësit në arsimin fillor dhe të mesëm.

(15) Ministri dhe botuesi i vendit, përkatësisht botuesi i jashtëm, nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar ligjor në Republikën e Maqedonisë, për librin mësimor të lejuar të adaptuar nga jashtë të harmonizuar me program të miratuar mësimor të adaptuar dhe të përkthyer nga Qendra Ndërkombëtare për Programe Mësimore të Kembrixhit (Cambridge International Examinations) nënshkruajnë marrëveshje në të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella.

Neni 14

(1) Gjatë miratimit të plan-programit të ri mësimor ose nëse bëhet ndryshimi ose plotësimi i më shumë se 30% i plan-programit mësimor, Shërbim pedagogjik shpall konkurs për libër të ri shkollor për lëndën përkatëse.

(2) Për ngritjen permanent të cilësisë dhe modernizimit të librit shkollor të lejuar, pas përdorimit pesëvjeçar të librit nga botimi i parë, Shërbimi pedagogjik mund të shpallë konkurs të ri, sipas mendimit paraprak të Byrosë, respektivisht të Qendrës për arsim dhe aftësim profesional, përkatësisht të Qendrës për arsimin e të rriturve.

Neni 15

(1) Në konkursin për libër shkollor, autori i librit, përveç dokumentacionit tjetër të përcaktuar me ligj, detyrimisht i bashkëngjit edhe:

- dorëshkrimin për librin të përpunuar me art dhe grafikë dhe me redakturë gjuhësore në formë të dorëshkrimit dhe në formë elektronike, dhe
- deklaratën e lektorit për redakturën gjuhësore të tekstit.

(2) Nëse autori konsideron se ka nevojë për mjete ndihmëse mësimore (fletore pune, fletore ushtrimesh etj.) të dorëshkrimit për libër, të njëjtën e dorëzon në formë elektronike.

Neni 16

(1) Drejtori i Shërbimit Pedagogjik shpall konkurs publik për recensentë së paku në dy gazeta publike nga të cilat së paku në një nga gazetatat që botohen në gjuhën maqedonase dhe në gazetatat që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase dhe nga kandidatet e paraqitur kryen zgjedhje.

(2) Komisioni Nacional, nga recensentët nga paragrafi (1) i këtij neni, formon Komision të Recensentëve, që e kryen vlerësimin e dorëshkrimeve për libër shkollor për lëndën adekuate, në pajtim me metodologjinë që e propozon Byroja, kurse e përcakton ministri. Gjatë vlerësimit profesional të librit shkollor Komisioni i Recensentëve veçanërisht kujdeset që të mos ofendohen historia, kultura dhe vlerat tjera të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, popullit maqedonas, si dhe qytetarëve që jetojnë brenda kufijve të saj që janë pjesë e popullit shqiptar, turk, vllleh, serb, rom, boshnjak e të tjerë. Anëtarët e Komisionit të Recensentëve janë përgjegjës për demin e shkaktuar nëse libri shkollor tërhiqet nga përdorimi për shkak të gabimeve serioze dhe të dukshme në vlerësimin profesional të dorëshkrimit për libër shkollor.

(3) Komisioni recensues nga paragrafi (2) i këtij neni përbëhet prej tre anëtarëve:

- një arsimtar recensent nga fakultetet e arsimtarisë për lëndën mësimore për të cilën dedikohet libri dhe me së paku dhjetë vjet përvojë pune në mësimdhënie dhe
- dy recensentë arsimtarë nga shkolla fillore, respektivisht shkolla e mesme përkatëse për lëndën mësimore për të cilin dedikohet libri dhe me së paku dhjetë vjet përvojë pune në mësimdhënie.

(4) Në përbërjen e komisionit për vlerësimin profesional të librit që i dedikohet nxënësve që e ndjekin mësimin në gjuhën dhe në alfabetin e ndryshëm nga gjuha maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, një nga anëtarët është nga radhët e pjesëtarëve të bashkësive të cilëve u dedikohet libri.

(5) I punësuar në Ministri, në organet në përbërje të Ministrisë, në Qendrën për arsim dhe aftësim profesional, Qendrën për arsim të të rriturve, autori i dorëshkrimit të librit të dorëzuar, kryetari dhe anëtari i Komisionit nacional ose personi i cili është në marrëdhënie tjetër kontraktuese me autorin të cilët do të mund të ndikojnë në objektivitetin e vlerësimit, si dhe anëtarët e familjes së tyre të ngushtë (bashkëshorti/tja, fëmijët, prindërit, vëllezërit dhe motrat) nuk mund të jenë anëtarë të komisionit recensues, për çka dorëzon deklaratë në Shërbimin pedagogjik.

(6) Mënyrën e zgjedhjes, emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të komisionit të recensionit dhe mënyrën e punës së komisionit të recensionit i përcakton ministri.

Neni 17

(1) Shërbimi Pedagogjik dorëshkrimin për libër shkollor e dorëzon në Komisionin e Recensentëve dhe në Byro, në afat prej shtatë ditësh nga dita e mbarimit të konkursit.

(2) Komisioni i Recensentëve kryen vlerësim profesional të dorëshkrimit në pajtim me Metodologjinë për vlerësim të tekstit shkollor, në afat prej 14 ditësh nga dita e pranimit të dorëshkrimit të tekstit shkollor dhe ia dorëzon listën për vlerësim profesional të dorëshkrimeve të librave shkollorë drejtorit të Shërbimit Pedagogjik.

(3) Byroja, në afat prej shtatë ditësh nga dita e pranimit të dorëshkrimit për libër shkollor, drejtorit të Shërbimit Pedagogjik i dorëzon mendim të arsyetuar për harmonizimin e dorëshkrimit të librit shkollor me programin mësimor.

(4) Drejtori i Shërbimit Pedagogjik, në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të vlerësimit profesional nga Komisioni i Recensentëve dhe mendimit nga Byroja, anëtarit referues, respektivisht anëtarëve referues të përcaktuar nga Komisioni Nacional ua dorëzon vlerësimet profesionale të dorëshkrimeve dhe të librave shkollorë nga Komisioni i Recensentëve, dorëshkrimet e librave shkollorë, si dhe mendimin nga Byroja për harmonizimin e dorëshkrimeve të librave shkollorë me programin mësimor.

(5) Nëse në konkursin nga neni 12 paragrafi (2) të këtij ligji janë dorëzuar më shumë se katër dorëshkrime për libra shkollorë për një lëndë mësimore, Komisioni Nacional përcakton dy ose më shumë anëtarë referues.

(6) Anëtari referues, respektivisht anëtarët referues në afat prej dhjetë ditësh nga dita e pranimit të vlerësimit profesional të dorëshkrimeve të librave shkollorë nga Komisioni i Recensentëve, dorëshkrimet e librave shkollorë si dhe mendimin nga Byroja, i referon Komisionit Nacional dhe jep propozim për zgjedhjen e dorëshkrimit më të mirë të librit shkollor.

(7) Komisioni Nacional miraton vendim në afat prej tri ditësh nga dita e referimit të anëtarit referues, respektivisht anëtarëve referues.

(8) Nëse Komisioni Nacional nuk merr vendim me të cilin zgjidhet dorëshkrimi më i mirë për libër shkollor, përkatësisht nuk miraton aktvendim për refuzimin e kërkesës në afatin nga paragrafi (7) i këtij neni, pjesëmarrësi në konkurs ka të drejtë që në afat prej tri ditëve të punës nga kalimi i atij afati të parashtojë kërkesë në sekretarinë e kryetarit të Komisionit Nacional, për marrjen e vendimit.

(9) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (8) i këtij neni i përcakton ministri.

(10) Kryetari i Komisionit Nacional detyrohet që në afat prej pesë ditëve të punës nga pranimi i kërkesës nga paragrafi (8) i këtij neni, në sekretarinë e kryetarit të Komisionit nacional, të miratojë aktvendim me të cilin kërkesa pranohet apo refuzohet. Nëse kryetari i Komisionit nacional nuk ka sekretari, kërkesa parashtrohet në sekretarinë e selisë së Shërbimit Pedagogjik.

(11) Nëse kryetari i Komisionit nacional nuk miraton aktvendim në afatin nga paragrafi (10) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ në afat prej pesë ditëve të punës.

(12) Inspektorati Shtetëror Administrativ detyrohet që në afat prej dhjetë ditësh nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (11) i këtij neni, të kryejë mbikëqyrje inspektuese në Komisionin nacional nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së kryer ta njoftojë pjesëmarrësin në konkurs për gjendjen e konstatuar gjatë mbikëqyrjes së kryer.

(13) Inspektori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nga paragrafi (12) pas mbikëqyrjes së kryer në pajtim me ligjin, miraton aktvendim me të cilin e ngarkon kryetarin e Komisionit Nacional që në afat prej dhjetë ditësh të vendos për kërkesën e parashtruar, përkatësisht ta pranojë apo refuzojë kërkesën dhe për masat e ndërmarra në afatin e njëjtë, ta njoftojë inspektorin dhe t'i dorëzojë ekzemplar të aktit me të cilin është vendosur për kërkesën.

(14) Nëse kryetari i Komisionit nacional nuk vendos në afatin nga paragrafi (13) i këtij neni, inspektori do të parashtojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ dhe do të përcaktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës në të cilin kryetari i Komisionit nacional do të vendos për kërkesën e parashtruar, për çfarë në afatin e njëjtë do ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dorëzohet kopje e aktit me të cilin ka vendosur për konkursin e shpallur. Inspektori në afat prej tri ditëve të punës e informon pjesëmarrësin në konkurs për masat e ndërmarra.

(15) Nëse kryetari i Komisionit nacional nuk vendos as në afatin plotësues nga paragrafi (14) i këtij neni, inspektori në afat prej tri ditëve të punës do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent dhe në atë afat do ta informojë pjesëmarrësin në konkurs për masat e ndërmarra.

(16) Nëse inspektori nuk vepron sipas njoftimit nga paragrafi (12) i këtij neni, pjesëmarrësi në konkurs në afat prej pesë ditëve të punës ka të drejtë të parashtojë kundërshtim në sekretarinë e

drejtorit të Inspektoratit Shtetëror Administrativ. Nëse drejtori nuk ka sekretari, kërkesa parashtrohet në sekretarinë e selisë së Inspektoratit Shtetëror Administrativ.

(17) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ detyrohet që në afat prej tri ditëve të punës nga dita e pranimit ta shqyrtojë kundërshtimin nga paragrafi (16) i këtij neni dhe nëse konstaton se inspektori nuk ka vepruar pas njoftimit nga pjesëmarrësi në konkurs në pajtim me paragrafin (12) të këtij neni ose nuk parashtron kallëzim në pajtim me paragrafin (15) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të parashtojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ kundër inspektorit dhe do të caktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës në të cilin inspektori do të kryejë mbikëqyrje në organin kompetent nëse procedura është zbatuar në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së kryer, ta informojë pjesëmarrësin në konkurs për masat e ndërmarra.

(18) Nëse inspektori nuk vepron as në afatin plotësues nga paragrafi (17) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent dhe në afat prej tri ditëve të punës do ta informojë pjesëmarrësin në konkurs për masat e ndërmarra.

(19) Në rastin nga paragrafi (18) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ menjëherë, e më së voni në afat prej një dite të punës, do të autorizojë inspektor tjetër që ta kryejë mbikëqyrjen menjëherë.

(20) Në rastin nga paragrafi (19) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ në afat prej tri ditëve të punës, e informon pjesëmarrësin në konkurs për masat e ndërmarra.

(21) Nëse drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nuk vepron në pajtim me paragrafin (17) të këtij neni, pjesëmarrësi në konkurs mund të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent në afat prej tetë ditëve të punës.

(22) Nëse kryetari i Komisionit nuk vendos në afatin nga paragrafi (15) i këtij neni, pjesëmarrësi në konkurs, mund të ngritë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

(23) Procedura në Gjykatën Administrative është urgjente.

(24) Kundër vendimit të Komisionit Nacional, në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të vendimit, mund të parashtrohet ankese në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(25) Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë vendos për ankesën e parashtruar në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të ankesës.

(26) Pas përfundimit të vendimit për lejimin dhe përdorimin e librit shkollor, Shërbimi Pedagogjik publikon katalog të librave shkollorë të lejuar për përdorim, në ueb faqen e Ministrisë.

- (27) Në katalogun e librave shkollorë të lejuar futet libri shkollor i blerë i adaptuar nga jashtë.
- (28) Katalogu nga paragrafi (11) i këtij neni publikohet më së voni deri më 30 prill të vitit vijues.
- (29) Formën dhe përmbajtjen e katalogut e përcakton ministri.

Neni 17-a

- (1) Nëse në konkursin nga neni 12 paragrafi (2) i këtij ligji nuk paraqitet asnjë autor i librit shkollor me dorëshkrim për libër shkollor ose konkursi publikohet për lëndë mësimore që për herë të parë futet në arsimin fillor, respektivisht të mesëm ose Komisioni Nacional miraton vendim se nuk kryen zgjedhje nga dorëshkrimet e dorëzuara për libra shkollorë, ministri me propozim të drejtorit të Shërbimit Pedagogjik, formon ekip të autorëve për përpunimin e dorëshkrimit për libër shkollor.
- (2) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni në përbërjen e ekipit të autorëve mund të zgjidhet edhe autori që nuk i plotëson kushtet për përvojën e punës prej së paku dhjetë vjet si arsimtar në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë për lëndën mësimore adekuate që i dedikohet libri shkollor, respektivisht përvojën e punës së paku dhjetë vjet si arsimtar në arsimin fillor, të mesëm ose të lartë në mënyrë adekuate sipas programit mësimor për lëndën që i dedikohet libri shkollor.
- (3) Ekipi i autorëve nga paragrafi (1) i këtij neni, më së voni në afat prej 60 ditësh nga dita e formimit, drejtorit të Shërbimit Pedagogjik i dorëzon dorëshkrim për libër shkollor.
- (4) Drejtori i Shërbimit Pedagogjik, në afat prej dy ditësh nga dita e pranimit të dorëshkrimit të librit shkollor, e dorëzon në Komisionin Nacional dhe në Byro.
- (5) Komisioni Nacional, në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të dorëshkrimit për libër shkollor, formon Komision të Recensentëve.
- (6) Komisioni i Recensentëve, në afat prej shtatë ditësh nga dita e pranimit të dorëshkrimit për libër shkollor, kryen vlerësim profesional të dorëshkrimit për libër shkollor të përpunuar nga ekipi i autorëve dhe ia dorëzon drejtorit të Shërbimit Pedagogjik.
- (7) Byroja, në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të dorëshkrimit për libër shkollor, drejtorit të Shërbimit Pedagogjik i dorëzon mendim të arsyetuar për harmonizimin e dorëshkrimit të librit shkollor me programin mësimor.
- (8) Drejtori i Shërbimit Pedagogjik, në afat prej dy ditësh nga dita e pranimit të vlerësimit profesional nga Komisioni i Recensentëve dhe mendimit nga Byroja, referuesit respektivisht anëtarëve referues të përcaktuar nga Komisioni Nacional, ua dorëzon vlerësimet profesionale të dorëshkrimeve të librave shkollorë nga Komisioni i Recensentëve, dorëshkrimet e librave shkollorë, si dhe mendimin nga Byroja për harmonizimin e dorëshkrimeve të librave shkollorë me programin mësimor.

(9) Anëtari referues, në afat prej shtatë ditësh nga dita e pranimit të vlerësimeve profesionale të dorëshkrimeve të librave shkollorë nga Komisioni i Recensentëve, dorëshkrimet e librit shkollor si dhe mendimit nga Byroja, referon në Komisioni Nacional dhe jep propozim për lejimin dhe përdorimin e dorëshkrimit të librit shkollor nga ekipi i autorëve.

(10) Komisioni Nacional miraton vendim në afat prej tri ditësh nga dita e referimit të anëtarit referues.

(11) Kundër vendimit të Komisionit Nacional, në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të vendimit, mund të paraqitet ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(12) Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë, vendos për ankesën e parashtruar në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të ankesës.

Neni 18

(1) Ministri dhe autori i librit nënshkruajnë marrëveshje për bartjen e të drejtës materiale të autorit në të cilën përcaktohen të drejtat dhe obligimet midis tyre.

(2) Nëse autori i librit në konkurs ka ofruar literaturë plotësuese në pajtim me nenin 15 paragrafi (2) i këtij ligji, të njëjtën është i detyruar t'ia japë pa bartjen e të drejtës materiale të autorit.

(3) Nëse autori nuk e nënshkruan marrëveshjen nga paragrafi (1) i këtij neni, ministri lidh marrëveshje me autorin që pason nga lista përfundimtare nga paragrafi (6), respektivisht propozimi përfundimtar nga paragrafi (7) i nenit 17 të këtij ligji.

(4) Ministri dhe ekipi i autorëve nga neni 17-a paragrafi (1) të këtij ligji nënshkruajnë marrëveshje për bartjen e të drejtës materiale të autorit në të cilën verifikohen të drejtat dhe obligimet e ndërsjella.

Neni 19

(1) Në bazë të marrëveshjes nga neni 18 paragrafët (1), (3) dhe (4) të këtij ligji, Shërbimi pedagogjik shpall thirrje publike për botimin e librave shkollorë.

(2) Zgjedhjen e ofertës më të volitshme për botim të librit shkollor e bën komisioni për furnizime publike.

Neni 20

Ministria është e detyruar që librin shkollor nga gjuha maqedonase ta përkthejë dhe ta botojë në gjuhën dhe në alfabetin e pjesëtarëve të bashkësive të cilët të njëjtin do ta shfrytëzojnë.

Neni 21

Në librin shkollor botohen të dhënat si vijon:

- emri dhe mbiemri i autorit ose autorëve të librit shkollor,
- emri dhe mbiemri i ilustruesit,
- emri dhe mbiemri i përkthyesit dhe të dhënat për botuesin, nëse libri shkollor është i përkthyer,
- emri dhe mbiemri i recensentit,
- emri dhe mbiemri i lektorit gjuhësor,
- emri dhe mbiemri i redaktorit,
- emri dhe selia e organizatës botuese,
- emri dhe selia e organizatës shtypëse,
- tirazhi i librit,
- numri dhe data e aktvendimit të ministrit me të cilin lejohet libri shkollor për përdorim, dhe
- CIP Katalogizimi në publikimin e Bibliotekës Popullore dhe Universitare (“Shën Klimenti i Ohrit” –Shkup).

Neni 22

Libri shkollor nuk guxon të përmbajë porosi reklamuese dhe shpallje.

IV. Përdorimi i librave

Neni 23

(1) Çdo libër shkollor mund të jetë në përdorim pesë vite shkollore. Libri shkollor zgjidhet nga katalogu i librave shkollorë të miratuar, për çfarë merr vendim këshilli i mësimdhënësve të shkollës me propozim të aktiveve profesioniste në shkolla fillore, përkatësisht të mesme dhe përfaqësuesve të prindërve të nxënësve.

(2) Për numrin e nevojshëm të librave shkollorë që janë dëmtuar dhe nuk janë për përdorim, shkolla është e obliguar që me shkrim ta njoftojë Shërbimin Pedagogjik, deri në fund të majit në vitin rrjedhës.

(3) Në bazë të njoftimeve të marra nga paragrafi 2 i këtij neni, Shërbimi Pedagogjik çdo vit kryen zëvendësim të librave shkollorë të dëmtuar me libra shkollorë të rinj.

(4) Për numrin e duhur të librave shkollorë që do të jenë në përdorim gjatë vitit të ardhshëm shkollor, shkolla është e detyruar që me shkrim ta informojë Shërbimin pedagogjik, deri në fund të muajit prill të vitit rrjedhës.

Neni 24

(1) Çdo nxënës në fillim të vitit shkollor merr falas kompletin e librave shkollorë.

(2) Arsimitarët janë të detyruar që t'u tregojnë nxënësve dhe prindërve se librat shkollor nuk guxojnë të dëmtohen, shkarraviten ose të nënvizohen pjesë të caktuara të tekstit në librin shkollor.

Neni 25

(1) Nxënësi pas mbarimit të vitit mësimor është i detyruar që t'ia kthejë shkollës kompletin e librave shkollor të pa dëmtuar, përveç librat shkollorë në të cilat ka përmbajtje që nxënësi i plotëson me shkrim, ngjyrosje ose faqe të caktuara të librit shkollor i plotëson me prerje dhe ngjitje.

(2) Nxënësit që janë në provim, e kthejnë kompletin e librave shkollorë pas mbarimit të vitit shkollor, përveç librat shkollorë në të cilat ka përmbajtje që nxënësi i plotëson me shkrim, ngjyrosje ose faqe të caktuara të librit shkollor i plotëson me prerje dhe ngjitje.

(3) Nëse nxënësi nuk e kthen kompletin e librave shkollorë ose e kthen të dëmtuar, prindi, respektivisht tutori i nxënësit e kompenson vlerën e kompletit të librave shkollorë, respektivisht të librit shkollor, me pagesën e 70% të vlerës së katalogut të librit shkollor.

(4) Çdo shkollë është e detyruar që të formojë fondin e librave shkollorë. Për çdo vit të ardhshëm vlera zvogëlohet për 10%.

(5) Përgjegjës për fondin e librave shkollorë në shkollë është drejtori i shkollës.

(6) Përgjegjës në shkollë për pranimin, vendosjen, shpërndarjen dhe kthimin e kompleteve të librave shkollorë janë drejtori i shkollës, përgjegjësi i klasës respektivisht kujdestari i klasës, arsimtarët dhe bibliotekarët.

(7) Mënyrën e pranimit, të vendosjes, shpërndarjes dhe kthimit të kompleteve të librave shkollorë e përcakton ministri.

V. Tërheqja e librit shkollor nga përdorimi

Neni 26

(1) Libri shkollor tërhiqet nga përdorimi nëse miratohet plan-programi i ri mësimor ose nëse bëhet ndryshimi ose plotësimi i më shumë se 30% të planit dhe programit mësimor dhe nëse nuk i përmbush qëllimet shkencore-profesionale dhe metodologjike.

(2) Libri shkollor tërhiqet nga përdorimi edhe nëse përmban materiale me të cilën ofendohen historia, kultura dhe vlerat tjera të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, popullit maqedonas, si dhe qytetarëve të cilët jetojnë në kufijtë e saj që janë pjesë e popullit shqiptar, popullit turk, popullit vllah, popullit serb, popullit rom, popullit boshnjak e të tjerë.

(3) Për tërheqjen e librit shkollor nga përdorimi i cili nuk i plotëson qëllimet shkencore profesionale dhe metodologjike, si dhe për shkaqe nga paragrafi (2) i këtij neni, ministri formon

komision të përbërë prej shtatë anëtarësh prej të cilëve nga dy anëtarë nga Ministria, dy anëtarë nga radhët e arsimtarëve të dalluar dhe nga një anëtar këshilltar nga Byroja ose nga Qendra për arsim dhe aftësim profesional ose nga Qendra për arsimin e të rriturve të sferës për të cilën është dedikuar libri shkollor, nga Inspektorati shtetëror i arsimit dhe mësimdhënës të fakultetit përkatës.

(4) Me propozim të komisionit nga paragrafi (3) i këtij neni, ministri mund të tërheqë nga përdorimi libër shkollor të lejuar.

V-a. Mbikëqyrja

Neni 26-a

Mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji e kryen Inspektorati Shtetëror i Arsimit.

Neni 26-b

(1) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese Inspektorati Shtetëror i Arsimit përcakton se për herë të parë është kryer parregullsi nga neni 27 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji, detyrohet që të përpilojë procesverbal në të cilin do ta përcaktojë parregullsinë e konstatuar me sugjerim për mënjanimin e parregullsisë së konstatuar në afat prej tetë ditësh dhe me dorëzim të njëkohshëm të ftesës për zbatim të edukimit të personit ose institucionit ku është konstatuar parregullsia gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

(2) Formën dhe përmbajtjen e ftesës për edukim, si dhe mënyrën e zbatimit të edukimit, i përcakton ministri.

(3) Edukimin e organizon dhe e zbaton Inspektorati Shtetëror i Arsimit, pas kalimit të afatit nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Edukimi mund të zbatohet për parregullsi të konstatuara të njëjta ose të ngjashme për një ose më shumë presona respektivisht një ose më shumë institucione.

(5) Nëse në terminin e caktuar personi ose institucioni për të cilin zbatohet edukimi nuk paraqiten në edukim, do të llogaritet se edukimi është zbatuar.

(6) Nëse personi ose institucioni për të cilët zbatohet edukimi paraqiten në edukimin e caktuar dhe e mbarojnë atë, do të konsiderohet se është edukuar në lidhje me parregullsinë e përcaktuar.

(7) Nëse inspektori shtetëror i arsimit gjatë zbatimit të mbikëqyrjes së kontrollit konstaton se janë mënjeluar parregullsitë e konstatuara nga paragrafi (1) i këtij neni, miraton konkluzion me të cilin e ndërpret procedurën e mbikëqyrjes inspektuese.

(8) Nëse inspektori shtetëror i arsimit, gjatë zbatimit të mbikëqyrjes kontrolluese konstaton se nuk janë mënjeluar parregullsitë e konstatuara nga paragrafi (1) i këtij neni, parqet kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse në gjykatën kompetente.

(9) Inspektorati Shtetëror i Arsimit, mban evidencë për edukimin e zbatuar në mënyrë të përcaktuar nga ministri.

VI. Dispozitat për kundërvajtje

Neni 27

(1) Gjobë në shumë prej 3.000 deri 5.000 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje shkollës fillore respektivisht të mesme, nëse:

- lejon shitje të literaturës profesionale dhe revistave për fëmijë në shkollën fillore respektivisht të mesme (neni 6-a paragrafi (3)).

(2) Gjobë në shumë prej 1.500 deri 2.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës në personin juridik, për kundërvajtjet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 5.000 deri në 10.000 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje shkollës fillore respektivisht të mesme nëse:

- nuk formon fond të librave shkollorë (neni 25 paragrafi (4)) dhe

- nuk organizon pranim, magazinim, ndarje dhe kthim të completeve të librave shkollorë (neni 25 paragrafi (6)).

(4) Gjobë në shumë prej 2.500 deri në 5.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës në personin juridik, për kundërvajtje nga paragrafi (3) i këtij neni.

(5) Gjobë në shumë prej 10.000 deri në 15.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje shkollës fillore respektivisht të mesme, nëse:

- përdor libra shkollorë që nuk janë lejuar nga Komisioni Nacional (neni 17 paragrafi (9)).

(6) Gjobë në shumë prej 5.000 deri në 7.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës në personin juridik, për kundërvajtje nga paragrafi (5) i këtij neni.

(7) Gjobë në shumë prej 2.500 deri në 3.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet edhe arsimtarit për kundërvajtje nga paragrafi (5) i këtij neni.

Neni 28

Organ kompetent për kumtimin e sanksioneve për kundërvajtje është gjykata kompetente.

Neni 29

Para dorëzimit të kërkesës për procedurë të kundërvajtjes, për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë ligj, Inspektorati shtetëror i arsimit mban procedurë për barazim në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

VII. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 30

Aktet nënligjore të parapara në këtë ligj, ministri do t'i miratojë në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes së tij në fuqi.

Neni 31

Deri në nxjerrjen e akteve të parapara me këtë ligj do të zbatohen aktet ekzistuese.

Neni 32

Procedurat që kanë filluar para hyrjes në fuqi të këtij ligji do të përfundojnë në pajtim me Ligjin për arsim fillor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 63/04, 82/04, 55/05, 81/05, 113/05, 35/06, 70/06 dhe 51/07) dhe në pajtim me Ligjin për arsim të mesëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08 dhe __/08).

Neni 33

Dispozita e neneve 6 dhe 24 nga ky ligj do të zbatohet prej 1 shtator 2009.

Neni 34

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji pushojnë të vlejné dispozitat e neneve 105 paragrafi 2 dhe 3, neni 106, 107, 108, 109, 110, 111, 112, 113, 114, 115, 117, 118, 119, 120, 121, 122 dhe 123 nga Ligji për arsim fillor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër __/08) dhe dispozitat nga neni 31, 31-a, 31-b, 31-v, 31-g, 31-d, 31-gj, 31-e, 31-zh, 31-z, 31-x, 31-i dhe 31-j nga Ligji për arsim të mesëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08 dhe 92/08).

Neni 35

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".